- Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për gatimin e kremrave, brumrave dhe asortimenteve të tyre.
- Peshore, dozatorë, sita, brumatriçe, sfoliatriçe, tavolina pune, furra për pjekje.
- Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli “Gatimi i asortimenteve për pritje dhe bankete”

Drejtimi: Hoteleri- Turizëm
Profili: Kuzhinë-Pastiçeri
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	GATIMI I ASORTIMENTEVE PËR PRITJE DHE BANKETE.	M-13-438-10
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer veprimet paraprake si dhe për të përgatitur në asortimente për bankete dhe pritje.	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Hoteleri-Turizëm.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen proceset përgatitore për përgatitjen e menuve të banketeve dhe pritjeve.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Analiza e menisë.- Përgatitja e planit të prodhimit.- Përzgjedhja e mjeteve të punës.- Kontrolli i funksionimit të pajisjeve.- Kujdesi për pajisjet.- Vendosja e pajisjeve në punë.- Përzgjedhja e lëndëve të para sipas menisë.- Peshimi i lëndëve të para.- Larja, pastrimi dhe përgatitja e lëndëve të para për përgatitjen e menisë së përcaktuar.- Rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjes për realizimin e menisë së banketeve dhe pritjeve. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të zërthejë menunë e banketit dhe pritjeve;- të përgatitë planin e prodhimit;- të përzgjedhë mjetet e duhura të punës për përgatitjen e menisë së përcaktuar;- të kontrollojë funksionimin e pajisjeve;- të kujdeset për pajisjet;- të vendosë pajisjet në punë;- të bëjë përzgjedhjen e lëndëve të para sipas recepturës;	



-
- të bëjë peshimin e saktë të lëndëve të para sipas recepturës;
 - të bëjë larjen, pastrimin e lëndëve të para për përgatitjen e menusë së përcaktuar;
 - të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjes për realizimin e menusë së banketit dhe pritjes.

RM 2 Nxënësi përgatit asortimente të menuve për bankete të zakonshme dhe festive.

Përmbajtja:

- Përgatitja e pjatave të para të ftohta në menutë fikse.
- Përgatitja e supave në menutë fikse.
- Përgatitja e pjatave të para të ngrohta në menutë fikse.
- Përgatitja e pjatave kryesore me peshk në menutë fikse.
- Përgatitja e pjatave kryesore me mish në menutë fikse.
- Përgatitja e deserteve në menutë fikse.
- Përgatitja e dekoruesve (shtesave) për asortimente të menusë së banketit.
- Vendosja e ushqimeve në pjatat e klientëve në banket.
- Dekorimi i pjatave në banket.
- Servirja e menuve fikse.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së asortimenteve të menuve për bankete.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë pjata të para të ftohta në menutë fikse;
- të përgatitë supa në menutë fikse;
- të përgatitë pjata të para të ngrohta në menutë fikse;
- të përgatitë pjata kryesore me peshk në menutë fikse;
- të përgatitë pjata kryesore me mish në menutë fikse;
- të përgatitë deserte në menutë fikse;
- të përgatitë dekore për asortimente të menusë së banketit;
- të vendosë ushqimet në pjatat e klientëve në banket sipas rregullave;
- të dekorojë pjatat e klientëve në banket sipas rregullave;
- të servirë menutë në bankete duke zbatuar metoda të ndryshme të shërbimit;
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës;
- të bëjë pastrimin e vendit të punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së asortimenteve të menuve për bankete.

RM 2 Nxënësi përgatit asortimente të menuve për pritje të



zakonshme dhe festive.

Përmbajtja:

- Përgatitja e asortimenteve të bufeve të ftohta në pritje të zakonshme dhe festive.
- Përgatitja e asortimenteve të bufeve të ngrohta në pritje.
- Përgatitja e deserteve për pritjet.
- Përgatitja e dekoruesve (shitesave) për asortimente të menisë së pritjeve.
- Vendosja e ushqimeve në pjatancë në pritje.
- Dekorimi i pjatancave në pritje.
- Servirja e ushqimeve në pritje.
- Kujdesi për mjetet e punës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së asortimenteve të menuve për pritje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë asortimente të bufeve të ftohta në pritje;
- të përgatitë asortimente të bufeve të ngrohta në pritje;
- të përgatitë deserte për pritje;
- të përgatitë dekore për asortimente të menisë së pritjeve;
- të vendosë ushqimet në pjatancat e ushqimeve në pritje sipas rregullave;
- të dekorojë pjatancat me ushqim në pritje sipas rregullave;
- të servirojë menutë në pritje duke zbatuar rregullat e servirjes;
- të tregojë kujdesin e duhur për mjetet e punës;
- të bëjë pastrimin e vendit të punës;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së asortimenteve të menuve për pritje.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune të kuzhinës, por rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë shërbimin e kuzhinës.

-Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të përgatitjes së asortimenteve të ndryshme për bankete dhe pritje të zakonshme dhe festive duke përdorur mjetet dhe pajisjet përkatëse.

-Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për veprimet parapërgatitore si dhe për përgatitjen e asortimenteve të llojeve të ndryshme, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.

-Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.



- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Kuzhinë reale ose kuzhinë e shkollës.
- Kompleti i mjeteve, veglave dhe pajisjeve të kuzhinës për përgatitjen e asortimenteve të llojeve të ndryshme.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për gatimin e asortimenteve sipas menisë së përcaktuar në banket apo pritje.
- Manuale, udhëzuesat dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.



X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Gatimi i bukës dhe asortimenteve të saj në kuzhinë.”

Drejtimi: Hoteleri - Turizëm
Profili: Kuzhinë - Pastiçeri
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	GATIMI I BUKËS DHE ASORTIMENTEVE TË SAJ NË KUZHINË	M-13-439-10
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të gatuar asortimente të bukëve si dhe asortimente të ëmbla të tyre në kuzhinë duke zbatuar procesin teknologjik specifik për çdo asortiment dhe recepturat përkatëse.	
Kohëzgjatja e modulit	102 orë mësimore.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Hoteleri-Turizëm.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi gatuan simite/qahi/gjevrek me maja qiqre. Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve për prodhimin e simiteve. - Parapërgatitja e lëndëve të para dhe ndihmëse për prodhimin e simiteve. - Përzgjedhja e kokrave të qiqrës - Përgatitja e majasë së lëngshme nga kokrat e qiqrës. - Kontrolli organoleptik i përfundimit të fermentimit të majasë së lëngshme. - Gatimi i bashkëmajasë me maja të lëngshme. - Kontrolli organoleptik i përfundimit të fermentimit të bashkëmajasë (kujdes higjiena, sepse prishet fermentimi) - Përgatitja e brumëmajasë nga bashkëmajaja. - Kontrolli organoleptik i përfundimit të fermentimit të brumëmajasë. - Përgatitja e brumit kryesor. (temperature e ujit, mjedisit gjate gjithë prodhimit temp 38-42 °C - Përpunimi i brumit për simite. - Përpunimi i brumit për qahi. - Përpunimi i brumit për gjevrek. - Dekorimi 	

-
- Pjekja e simites.
 - Pjekja e qahisë.
 - Pjekja e gjevrekut.
 - Rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të simite/ qahi/gjevrek me maja qiqre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të interpretojë me korrektësi recepturën e përgatitjes së simiteve/ qahive/ gjevrekëve me maja qiqre;
- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e simiteve/ qahive/ gjevrekëve me maja qiqre;
- të përgatisë lëndët e para dhe ndihmëse për prodhimin e simiteve/ qahive/ gjevrekëve me maja qiqre;
- të për zgjedhë kokrat e qiqrës sipas standardit, formës, ngjyrës;
- të përgatisë majanë e lëngshme nga kokrat e qiqrës sipas recepturës;
- të bëjë kontrollin organoleptik të përfundimit të fermentimit të majasë së lëngshme;
- të gatujë bashkëmajanë me maja të lëngshme sipas procesit teknologjik;
- të bëjë kontrollin organoleptik të përfundimit të fermentimit të bashkëmajasë duke respektuar rregullat e higjienës gjatë fermentimit;
- të gatujë brumëmajanë nga bashkëmajaja sipas procesit teknologjik;
- të bëjë kontrollin organoleptik të përfundimit të fermentimit të brumëmajasë;
- të gatujë brumin kryesor në brumatriçe sipas procesit teknologjik duke respektuar temperaturën e ujit dhe mjedisit (38-42 °C)
- të kryejë sipas parametrave përpunimin e brumit për simite;
- të kryejë sipas parametrave përpunimin e brumit për qahi;
- të kryejë sipas parametrave përpunimin e brumit për gjevrek;
- të kryejë sipas parametrave dekorimin e simite/qahisë/gjevrekut;
- të kryejë sipas parametrave pjekjen e qahisë;
- të kryejë sipas parametrave pjekjen e simites;
- të kryejë sipas parametrave pjekjen e gjevrekut;
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të prodhimit të simites, qahisë, gjevrekut.

RM 2 Nxënësi gatuan bukë fshati (puljese, bagetë, misri).

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve për

- prodhimin e bukëve të fshatit.
- Parapërgatitja e lëndëve të para dhe ndihmëse.
- Gatimi i brumit me brumëmaja të tharët (natyrale).
- Përpunimi i brumit për bukë fshati.
- Dekorimi
- Pjekja e bukës së fshatit në tullë.
- Rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të bukëve të fshatit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë sipas rregullit përgatitjen e vendit dhe mjeteve të punës për prodhimin e bukës së fshatit
- të kryejë parapërgatitja e lëndëve të para dhe ndihmëse sipas recepturës;
- të gatujë brumin me brumëmaja të tharë (natyrale).
- të përpunojë brumin për bukë fshati sipas procesit teknologjik;
- të kryejë sipas modelin dekorimin e bukës së fshatit;
- të pjekë bukën e fshatit në tullë sipas parametrave.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të prodhimit të bukës së fshatit.

RM 3 Nxënësi gatuan asortimente buke me shtesa dhe fara drithore.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve për prodhimin e bukëve me shtesa dhe fara drithore.
- Parapërgatitja e lëndëve të para dhe ndihmëse (sipas recepturës).
- Parapërgatitja e lyrës si shtese.
- Parapërgatitja e aromatizuesve dhe erëzave.
- Përgatitja e ullirit, arrave dhe farërave të tjera.
- Përgatitja e qumështit si lëndë ndihmëse.
- Gatimi i brumit me maja të freskët dhe ulli.
- Gatimi i brumit me maja të freskët dhe arra.
- Gatimi i brumit me maja të freskët dhe fara.
- Gatimi i brumit me maja të freskët dhe qumësht.
- Gatimi i brumit me maja të freskët dhe aromatizues dhe erëza.
- Përpunimi i brumit për bukë sipas asortimentit.
- Dekorimi.
- Pjekja e bukës sipas asortimentit.
- Sistemimi dhe ambalazhimi i bukës.
- Rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të bukëve me shtesa dhe fara drithore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:



Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë sipas rregullit përgatitjen e vendit dhe mjeteve të punës për prodhimin e bukës me shtesa dhe fara drithore;
- të kryejë parapërgatitja e lëndëve të para dhe ndihmëse për prodhimin e bukës me shtesa dhe fara drithore sipas recepturës;
- të përgatisë sipas recetës lyrën;
- të përgatisë aromatizuesit dhe erëzat sipas recetës;
- të përgatisë ullirin, arrat, farërat sipas recetës;
- të përgatisë qumështit sipas recetës;
- të gatujë brumin me maja të freskët dhe ulli sipas procesit teknologjik;
- të gatujë brumin me maja të freskët dhe arra sipas procesit teknologjik;
- të gatujë brumin me maja të freskët dhe fara sipas procesit teknologjik;
- të gatujë brumin me maja të freskët dhe qumësht sipas procesit teknologjik;
- të gatujë brumin me maja të freskët dhe aromatizues dhe erëza sipas procesit teknologjik;
- të përpunojë brumin për bukë sipas asortimentit;
- të dekorojë asortimentet e brumit sipas modelit;
- të pjekë asortimentet e përgatitura sipas parametrave të paracaktuar në procesin teknologjik;
- të sistemojë dhe ambalazhojë asortimentet e bukës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të prodhimit të bukëve me shtesa dhe fara.

RM 5 Nxënësi gatuan kifle pa mbushje.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve për prodhimin e kifleve pa mbushje.
- Parapërgatitja e lëndëve të para dhe ndihmëse (sipas recepturës).
- Përgatitja e lyrës.
- Përgatitja e vezëve.
- Përgatitja e qumështit .
- Përgatitja e ëmbëlsuesve.
- Përgatitja e aromatizuesve dhe erëzave.
- Gatimi i brumit me maja të freskët dhe përbërësit e tjerë sipas recetës.
- Përpunimi i brumit për kifle.
- Dekorimi i kifleve.
- Pjekja e kifleve sipas asortimentit.
- Sistemimi dhe ambalazhimi i kifleve.
- Rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të kifleve pa mbushje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.



- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë e aftë:

- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitjen e vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve për prodhimin e kifleve pa mbushje;
- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitja e lëndëve të para dhe ndihmëse sipas recepturës për prodhimin e kifleve;
- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitjen e lyrës sipas kërkesave të procesit teknologjik;
- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitjen e vezëve sipas kërkesave të procesit teknologjik;
- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitjen e qumështit sipas kërkesave të procesit teknologjik;
- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitjen e ëmbëlsuesve sipas kërkesave të procesit teknologjik;
- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitjen e aromatizuesve dhe erëzave sipas kërkesave të procesit teknologjik;
- të gatujë i brumin me maja të freskët, me përbërësit e tjerë sipas recetës dhe procedurave të procesit teknologjik;
- të përpunojë brumin për kifle sipas standardit;
- të bëjë dekorimin e kifleve sipas modelit;
- të bëjë pjekjen e kifleve sipas asortimentit duke respektuar regjimin e parashikuar të pjekjes;
- të kryejë sistemimin dhe ambalazhimin e kifleve;
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të kifleve pa mbushje.

RM 6 Nxënësi gatuan kifle me mbushje.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve për prodhimin e kifleve me mbushje.
- Parapërgatitja e lëndëve të para dhe ndihmëse (sipas recepturës).
- Parapërgatitja e shtesave.
- Parapërgatitja e mbushësve (Marmalata, çokokrem, krem pastiçerie).
- Gatimi i brumit me maja të freskët
- Përgatitja e brumit për mbushje.
- Mbushja e brumit.
- Dekorimi i kifleve.
- Pjekja e kifleve, sipas asortimentit.
- Sistemimi dhe ambalazhimi i kifleve.
- Rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të kifleve me mbushje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitjen e vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve për prodhimin e kifleve me



- mbushje;
- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitja e lëndëve të para dhe ndihmëse sipas recepturës për prodhimin e kifleve me mbushje;
- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitjen e shtesave sipas kërkesave të procesit teknologjik;
- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitjen marmalades si shtesë sipas kërkesave të procesit teknologjik;
- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitjen e kremit të çokollatës sipas kërkesave të procesit teknologjik;
- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitjen e kremrave të tjerë sipas kërkesave të procesit teknologjik;
- të gatujë i brumin me maja të freskët, me përbërësit e tjerë sipas recetës dhe procedurave të procesit teknologjik;
- të përgatisë brumin për mbushje sipas standardit, formës dhe madhësisë së kifles;
- të bëjë mbushjen e brumit sipas rregullave;
- të bëjë dekorimin e kifleve sipas modelit;
- të bëjë pjekjen e kifleve sipas asortimentit duke respektuar regjimin e parashikuar të pjekjes.
- të kryejë sistemimin dhe ambalazhimin e kifleve.
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të kifleve me mbushje.

RM 7 Nxënësi gatuan kifile me brumë sfoljat (të petëzuar)

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve për prodhimin e kifleve me brumë sfoljat;
- Parapërgatitja e lëndëve të para dhe ndihmëse (sipas recepturës).
- Parapërgatitja e shtesave.
- Parapërgatitja e mbushësve.
- Përgatitja e brumit sfoljat me makinë.
- Përgatitja e brumit sfoljat me dorë.
- Përgatitja e brumit për mbushje.
- Mbushja e brumit.
- Dekorimi i kifleve.
- Pjekja e kifleve, sipas asortimentit.
- Sistemimi dhe ambalazhimi i kifleve.
- Rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të kifleve me brumë sfoljat.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitjen e vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve për prodhimin e kifleve me brumë sfoljat;
- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitja e lëndëve të para dhe ndihmëse sipas recepturës për prodhimin e kifleve me



- brume sfoljat;
- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitjen e shtesave sipas kërkesave të procesit teknologjik;
- të kryejë në mënyrë korrekte përgatitjen e mbushësve sipas kërkesave të procesit teknologjik;
- të përgatisë brumin sfoljat me makinë sipas procesit teknologjik;
- të përgatisë brumin sfoljat me dorë sipas procesit teknologjik ;
- të përgatisë brumin për mbushje sipas standardit, formës dhe madhësisë së kifles;
- të bëjë mbushjen e brumit sipas rregullave;
- të bëjë dekorimin e kifleve sipas modelit;
- të bëjë pjekjen e kifleve sipas asortimentit duke respektuar regjimin e parashikuar të pjekjes.
- të kryejë sistemimin dhe ambalazhimin e kifleve.
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të kifleve mebrumë sfoliat dhe mbushje.

Udhëzime për zbatimin e modulit

-Ky modul duhet të trajtohet në kuzhinën mësimore ose në mjedise reale pune të reparteve të gatimit të bukës, por rekomandohen dhe vizita në furra apo fabrika të tjera buke.

-Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të gatimit, pjekjes, ambalazhimit të asortimenteve të bukës si dhe demonstrime të përdorimit të mjeteve dhe materialeve të nevojshme për këto procese.

-Nxënësit duhet të përfshihen në veprimtari konkrete pune për përzgjedhjen dhe përgatitjen e miellit për gatim, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për proceset përgatitore dhe ato të gatimit dhe pjekjes se asortimenteve me miell gruri.

-Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e prodhimit të asortimenteve me miell gruri.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Repart për prodhimin e bukës ose klasë mësimore me poste pune për gatimin e bukëve dhe asortimenteve të ëmbla të tyre.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme gatimin e bukëve dhe asortimenteve të ëmbla të tyre.
 - Peshore, dozatorë, sita, brumatriçe, sfoliatrice, tavolina pune, furra për pjekje.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në
-



mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Komunikimi efektiv në shërbimet hoteliere”

Drejtimi: Hoteleri - Turizëm

Profili: Kuzhinë - Pasticëri

Niveli: II

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	KOMUNIKIMI EFEKTIV NË SHËRBIMET HOTELIERE	M-13-433-10
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të patur komunikim efektiv gjatë shërbimit duke respektuar rregullat në lidhje me të folurit dhe të vepruarit si dhe për të realizuar biseda të suksesshme me klientët.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit Hoteleri-Turizëm.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi komunikon me efektivitet.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Teknika e frymëmarrjes.- Përdorimi i zërit dhe i mënyrës së të folurit- Mjetet shprehëse melodioze, artikulatore.- Gjuha e trupit si pjesë përbërëse e një mesazhi.- Përdorimi imesazheve të gjuhës së trupit.- Interpretimi i sinjaleve të gjuhës së trupit.- Të dëgjuarit aktiv.- Biseda sqaruese dhe argumentuese.- Argumentimi bindës.- Sjellja vetjake në biseda.- Modele të komunikimit.- Përgatitja e një prezantimi- Vendorsja dhe arritja e qëllimeve gjatë prezantimeve.- Ndërtimi i fjalimeve.- Gabimet retorike, stresi dhe tensionet.- Retorika në telefon- Hapat e një bisede telefonike- Komunikimi sipas rubrikës telefonike. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përdorë teknikat e frymëmarrjes, qetësisimit, shtendosjes gjatë komunikimit duke eliminuar frymëmarrjen e gabuar,	



blackout;

- të përdorë tonalitetin e zërit, mënyrën e të folurit, modulimin, artikulimin për një komunikim efektiv;
- të përdorë gjuhën e trupit për transmetimin e mesazheve;
- të interpretojë sinjalet e gjuhës së trupit në komunikim;
- të zbatojë teknikat e të dëgjuarit aktiv;
- të kryejë biseda sqaruese dhe argumentuese;
- të bindë bashkëbiseduesit duke përdorur teknika të argumentimit;
- të analizojë sjelljen vetjake në biseda;
- të ndërtojë modele të ndryshme të komunikimit bazuar në 5 bazat e komunikimit;
- të përgatisë prezantime dhe të dallojë elementet e një prezantimi si mjete vizuale, emocionet, defektet, vëmëndja;
- të vendosë dhe të arrijë qëllime gjatë prezantimeve;
- të ndërtojë fjalime duke eliminuar gabimet retorike, stresin dhe tensionet.
- të kryejë biseda telefonike duke zbatuar hapat;
- të komunikojë në telefon sipas rubrikës telefonike.

RM 2 Nxënësi të kryejë biseda të suksesshme në shërbim.

Përmbajtja:

- Filozofia e shitjes.
- Shitja "hinkë".
- Shitja këshilluese.
- Klima e bisedës.
- Nevojat e klientëve.
- Avantazhet e të pyeturit.
- Dëgjimi i klientit.
- Prezantimi i produkteve apo shërbimeve në mënyrë të efektshme.
- Krijimi i marrëdhënies me klientin.
- Paraqitja e ofertës.
- Kundërshtimi dhe negocimi i çmimit.
- Paraqitja e çmimit.
- Vendim për blerje pa presion.
- Sinjale të blerjes.
- Përfundimi i suksesshëm i shitjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndërtojë bisedat e shitjes duke u bazuar në parimet e filozofisë së shitjes;
- të komunikojë si partner dhe jo si kundërshtar me klientin;
- të drejtojë pozitivisht në atmosferën e bisedës me klientin;
- të zbatojë teknikat e të pyeturit për të mësuar nevojat e klientëve;
- të dëgjojë klientin në lidhje me nevojat;



- të prezantojë produktet apo shërbimet duke përmendur dobinë dhe avantazhet, duke ju drejtuar rrafshit të ndjenjave dhe shqisave;
- të prezantojë ofertën me formulime pozitive, bindëse;
- të trajtojë sipas rregullave kundërshtimet dhe negociimet e çmimit nga klienti;
- të zbatojë teknika të paraqitjes dhe të negociimit të çmimit tek klienti;
- të ndikojë në vendimet e blerjes së klientit pa krijuar presion;
- të kuptojë sinjalet e blerjes nga klienti;
- të përfundojë me sukses shitjen.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë, por rekomandohen dhe vizita në bisnese.

- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave të ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet përkatëse.
- Mësuesi duhet të përdorë metodat e simulimit dhe të lojës me role për praktikimin e nxënësve.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari dhe situata konkrete pune fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore.
- Mjedise të barit, restorantit dhe guzhinës.
- Manuale, udhëzuesë dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.



3. Moduli “Llogaritje të koston dhe të çmimit në hoteleri”

Drejtimi: Hoteleri - Turizëm
Profili: Kuzhinë - Pasticëri
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	LLOGARITJE TË KOSTOS DHE TË ÇMIMIT NË HOTELERI	M-13-434-10
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit në llogaritjen e koston dhe të çmimit në kuzhinë dhe bar, restorant.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit Hoteleri-Turizëm.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi llogarit koston në kuzhinë, bar dhe restorant. Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">- Kuptimi për llogaritjen e koston.- Kuptimi për koston e njëjësive të shitura.- Kuptimi për koston fikse dhe variabël.- Kuptimi për koston direkte dhe indirekte.- Llogaritja e koston së pjatave në kuzhinë.- Llogaritja e koston së menuve fikse në kuzhinë.- Llogaritja e koston së aktiviteteve dhe pritjeve.- Llogaritja e koston së banketeve.- Llogaritja e koston së pijeve në bar. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.- Pyetje përgjigje me gojë.- Test me shkrim <p>Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të shpjegojë kuptimin e koston.- të shpjegojë llojet e kostove në shërbim.- të shpjegojë qëndrat e kostove në shërbim.- të shpjegojë koston fikse dhe koston variabël- të shpjegojë koston direkte dhe koston indirekte.- të përcaktojë elementët e koston në kuzhinë.	



- të përcaktojë koston e njësive të shitura në kuzhinë.
- të llogarisë koston e pjatave në kuzhinë.
- të llogarisë koston e menuve fikse.
- të llogarisë koston e aktiviteteve dhe pritjeve.
- të llogarisë koston e banketeve.
- të dallojë elementët e koston në bar
- të përcaktojë koston e njësive të shitura në bar.
- të llogarisë koston e pijeve të ngrohta në bar.
- të llogarisë koston e pijeve të ftohta në bar.
- të llogarisë koston e pijeve alkoolike në bar.
- të llogarisë koston e pijeve mikse (coctails) në bar.

RM 2 Nxënësi llogarit çmimin e asortimenteve në kuzhinë dhe të shërbimit në bar-restorant.

Përmbajtja:

- Kuptimi i llogaritjes së çmimit.
- Kuptimi i marzhit të kontributit (shuma mbuluese).
- Llogaritja e çmimit së pjatave në kuzhinë.
- Llogaritja e çmimit së menuve fikse në kuzhinë.
- Llogaritja e çmimit së aktiviteteve dhe pritjeve.
- Llogaritja e çmimit së banketeve.
- Llogaritja e çmimit së pijeve në bar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje përgjigje me gojë dhe me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë kuptimin e çmimit.
- të shpjegojë marzhin e kontributit (shuma mbuluese).
- të përcaktojë marzhe të ndryshme çmimi sipas formave të tregut.
- të llogarisë marzhin e kontributit për kuzhinën dhe për barin.
- të përcaktojë elementët e kalkulimit të çmimit në kuzhinë.
- të përcaktojë çmimin e njësive të shitura në kuzhinë.
- të llogarisë çmimin e menuve fikse.
- të llogarisë çmimin e aktiviteteve dhe pritjeve.
- të llogarisë çmimin e banketeve.
- të dallojë elementët e çmimin në bar
- të përcaktojë çmimin e njësive të shitura në bar.

- të llogarisë çmimin e pijeve të ngrohta në bar.
- të llogarisë çmimin e pijeve të ftohta në bar.
- të llogarisë çmimin e pijeve alkoolike në bar.
- të llogarisë çmimin e pijeve mikse (coctaille) në bar.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë.

- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për llogaritjen e kostos dhe cmimit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për llogaritje si dhe situata të llojeve të ndryshme, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore.
- Manuale, kataloge dhe flete detyrash, etj.

